



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 10

Tiranë – E hënë, 24 janar 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 19.1.2022	Për lirimin dhe emërimin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.....	1097
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 19.1.2022	Për emërimin e tre anëtarëve të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në.....	1097
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 11, datë 21.1.2022	Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve, për zgjedhjet e pjeshme vendore, për kryetar bashkie për disa njësi vendore.....	1097
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 32, datë 18.1.2022	Për një ndryshim në urdhrin nr. 99, datë 10.2.2021, “Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit”, të ndryshuar.....	1099

**VENDIM****Nr. 27, datë 19.1.2022**

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E
AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM TË
SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 1, 26, pika 5, shkronja “a”, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Brunilda Lilo, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Odise Moçka emërohet Avokat i Përgjithshëm i Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****VENDIM****Nr. 28, datë 19.1.2022**

**PËR EMËRIMIN E TRE ANËTARËVE
TË KOMISIONIT KOMBËTAR TË
PËRZGJEDHJES PËR TND-në**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Emërimin e tre anëtarëve të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në, si më poshtë vijon:

1. Z. Erind Mërkuri për një mandat 5-vjeçar;

2. Znj. Valbona Treska për një mandat 5-vjeçar;

3. Z. Erald Pashaj për një mandat 5-vjeçar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****UDHËZIM****Nr. 11, datë 21.1.2022**

**PËR PROCEDURAT E HARTIMIT TË
LISTAVE TË ZGJEDHËSVE, PËR
ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE,
PËR KRYETAR BASHKIE PËR DISA
NJËSI VENDORE**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 45, 46, 47, 48, 51, 56, 57, 59 dhe 62, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të dekretit nr. 13 438, datë 20.1.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore”,

UDHËZOJ:

1. Brenda datës 25.1.2022, nga Regjistri Kombëtar gjenerohet lista e zgjedhësve për bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, në përbërje të së cilës janë të gjithë shtetasit me të drejtë vote, të cilët deri në datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme vendore, më 6.3.2022, do të mbushin 18 vjeç.

2. Brenda datës 23.1.2022, nga Regjistri Kombëtar gjenerohet ekstrakti elektronik për zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative, për hartimin e listës së zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme vendore.

3. Në përgatitjen e listës së zgjedhësve respektohet dhe procedura e parashikuar në udhëzimin nr. 225, datë 11.5.2016, të ministrit të Punëve të Brendshme, “Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin, parashikuar nga ligji nr. 138/2015, ‘Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’”, të ndryshuar.

4. Grupimin e listës së zgjedhësve sipas zonave të qendrave të votimit, kufijtë e të cilave janë ato të zgjedhjeve të fundit. Për rastet e qendrave të votimit të konstatuara me më pak se 300 (treqind) zgjedhës, apo me më shumë se 1 000 (një mijë) zgjedhës, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në bashki/njësi administrative njofton kryetarin e emëruar me vendim të këshillit bashkiak, i cili brenda 48 orëve vendos për bashkimin dhe/ose ndarjen e tyre, sipas kërkesave të kriterit numerik



dhe cakton vendndodhjen dhe adresën e qendrave të votimit.

Për rastet e qendrave të votimit me fraksion që kalojnë limitin numerik të përcaktuar në ligj, kryetari i emëruar me vendim të këshillit bashkiak, në bashkitë ku do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme vendos për rindarjen e tyre, duke u nisur nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve të qendrës së votimit bazë. Numri i përgjithshëm i një qendre votimi, me të gjithë fraksionet e saj, do të ndahet në pjesë të barabarta, me jo më shumë se 1 000 (një mijë) zgjedhës secila.

5. Në rastin e institucioneve të posaçme (burgjet, vendet e paraburgimit, si dhe spitalet ose institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se tre ditë), të cilat përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi, limiti i poshtëm për qendrën e votimit i referohet një numri prej 15 (pesëmbëdhjetë) zgjedhësish, sipas përcaktimeve në nenin 62, pika 2, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

6. Për qendrat e votimit me më pak se 300 (treqind) zgjedhës, kryetari i emëruar me vendim të këshillit bashkiak në bashkitë ku do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme, vendos për bashkimin e kësaj qendre me një qendër më të afërt dhe me mundësi komunikimi rrugor, ku numri i përgjithshëm i zgjedhësve duhet të jetë të paktën 300 (treqind) zgjedhës.

Në rastet kur numri i përgjithshëm i zgjedhësve për qendrat që do të bashkohen rezulton të jetë më shumë se 1 000 (një mijë) zgjedhës, kryetari i emëruar me vendim të këshillit bashkiak, pas bashkimit të këtyre qendrave vendos për ndarjen me fraksion të qendrës së votimit të krijuar, sipas paragrafit të dytë të pikës 4, të këtij udhëzimi.

Nëse dy a më shumë qendra votimi kanë më pak se 300 (treqind) zgjedhës, qendra/qendrat me numër më të vogël zgjedhësish i bashkohen atyre me numër më të madh zgjedhësish.

7. Kryetari i emëruar me vendim të këshillit bashkiak, u dërgon në formë shkresore për zbatim zyrave të gjendjes civile, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në Ministrinë e Brendshme, vendimet për ndarjen ose bashkimin e qendrave të votimit, si dhe ndryshimet e adresave të qendrave të votimit nëse ka të tilla. Këto vendime i dërgohen menjëherë për dijeni dhe prefekut të qarkut Tiranë, Shkodër, Durrës, Dibër dhe Fier.

8. Zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative, ku do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme vendore kryejnë veprimet për zbatimin e vendimeve të kryetarit të emëruar me vendim të këshillit bashkiak, për ndarjen/bashkimin e qendrave të votimit në Regjistrin Kombëtar. Ky informacion përditësohet deri në orën 24:00 të së njëjtës ditë.

9. Procedurat e parashikuara në pikat 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9, të këtij udhëzimi, do të kryhen për listën e zgjedhësve që do të publikohet për zgjedhjet e pjesshme vendore.

10. Në rast se kryetarët e emëruar me vendim të këshillit bashkiak, në bashkitë ku do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme vendore nuk përmbushin detyrimet e parashikuara sipas pikave 3, 4, 5 dhe 6 të këtij udhëzimi, deri në publikimin e listës së zgjedhësve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile kryen menjëherë procesin e ndarjes dhe/ose bashkimin e qendrave të votimit sipas kritereve të përcaktuara në ligj.

Në përmbushje të këtij procesi, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile realizon bashkimin/ndarjen e qendrave të votimit, bazuar në kriterin numerik dhe mbiemrin e zgjedhësit. Qendrat e votimit me fraksion marrin automatikisht adresën e qendrës bazë.

Në rastet kur kryetari i emëruar me vendim të këshillit bashkiak, ka vendosur që adresa e qendrës së votimit me fraksion të jetë e ndryshme nga adresa e qendrës bazë, zyra e gjendjes civile në bashki /njësi administrative kryen veprimet për korrigjimin e adresës së qendrës së votimit sipas vendimit të kryetarit.

11. Më datë 25.1.2022, çdo zyrë e gjendjes civile në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, ku do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, printon listën e zgjedhësve nga Regjistri Kombëtar dhe firmos, vulos për çdo qendër votimi, duke përfshirë edhe institucionet e posaçme, nën juridiksionin territorial të saj dhe ia dorëzon kryetarit të emëruar me vendim të këshillit bashkiak.

12. Brenda datës 25.1.2022, kryetari i bashkisë i emëruar me vendim të këshillit bashkiak miraton, firmos dhe vulos listën dhe e dërgon në të tre formatet e parashikuara në Kodin Zgjedhor, në KZAZ-të përkatëse.



13. Në ushtrim të veprimtarisë së tyre, zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative ku do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, zbatojnë dhe vendimet gjyqësore, sipas nenit 57, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

14. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile publikon listën e zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme vendore më datë 25.1.2022, në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Brendshme.

15. Jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së listës së zgjedhësve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgon Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave një kopje të listës në format elektronik.

16. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi kryetarët e emëruar me vendim të këshillit bashkiak në bashkitë Shkodër, Dibrë, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, ku do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative, si dhe institucionet e tjera shtetërore të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

URDHËR

Nr. 32, datë 18.1.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 99, DATË 10.2.2021, “PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES BREND VENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 4 germa “d”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”; sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 5180, datë 23.12.2021. me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

VENDOSI:

Në urdhrin nr. 99, datë 10.2.2021, “Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, togfjalëshi “deri më datë 18.1.2022” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në datën 1.2.2022”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë